

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE- Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Beqir Kalludra, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.T., për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, dhe kundër të akuzuarve A.T., R.B., B.B.1 dhe B.B.2, për veprën penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.1298/14 të dt.16.03.2016, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt.17.10.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarit R.B., me dt.23.10.2018 mori, dhe të njejtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari R.B., i biri i B.3 dhe Sh., e gjinisë S., i lindur me ..., në fshatin P.1, tani me vendbanim në fshatin B.4, komuna e P.2, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me dt. 20.11.2014, rreth orës 02:00, në kafiterinë "T.S.", e cila gjendet në fshatin B.4 të komunës së P.2, i akuzuari R.B. në bashkëkryerje me të akuzuarit A.T., B.1 dhe B.B.2, me dashje që ti shkaktojnë lëndime trupore, kanë sulmuar tani të dëmtuarin G.G., në atë mënyrë që deri sa tani i dëmtuari G. në cilësinë e kamerierit, shkon tek tavolina e të pandehurve me qëllim që të bëj pagesën e faturës së pijeve, të pandehurit i drejtohen me fjalët merre atë faturë e qoja shefit e në momentin kur i dëmtuari u thotë "shefit faturën ja qoni ju" të pandehurit e sulmojnë atë duke e goditur me grushta e shqelma në pjesë të ndryshme të trupit me ç'rast të njetit i kanë shkaktuar dëmtime të përkohshme të shëndetit.

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 3, 4, 50, 41 lidhur me 45, 73, 74 dhe 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 par.4 dhe 463 par.2 të KPRK-së, e:

### G J Y K O N

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet e paushallit gjyqësor, shumën prej 20.00 (njëzetë) euro, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari G.G. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.1298/14 të dt.16.03.2016, kundër të akuzuarit B.T., për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, dhe kundër të akuzuarve A.T., R.B., B.B.1 dhe B.B.2, për veprën penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me dt.23.10.2018, dhe pas leximit të aktakuzës vetëm i akuzuari R.B. e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, të gjithë të akuzuarit tjerë nuk e kanë pranuar fajësinë, dhe bazuar në këto rrethana e me qëllim të ekonomizimit dhe racionalitetit të procedurës penale, gjykata ka marrë aktvendim përveçim dhe pezullim të procedurës penale dhe seanca ka vazhduar vetëm me të akuzuarin R.B., ndërkaq për të akuzuarit tjerë procedura penale do të vazhdojë me shqyrtimin e dytë.

Meqë i akuzuari R.B. e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjukata vlersojë se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit R.B., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në fund i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, t'ivlerësojë si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, si dhe ka kaluar një kohë bukur e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale.

I akuzuari R.B. në fund ka shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për veprimet e ndërmarra, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do t'i përsërit veprimet e tilla të ngjajshme, duke e lutur gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

Gjukata me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, të parapara sipas nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sqartë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i të njëjtit për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjëherë këto veprime, e në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se i dëmtuari nuk ka qenë prezent në seancën e shqyrtimit fillestar, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.294/18, dt.23.10.2018

Bashkëpunëtor profesional  
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Beqir Kalludra

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.